



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Tiranë 04/12/2025

Nr. K3/D21-6 Prot.

Nr. Dok. 202503277/6

Lënda: Plotësimi i detyrimit ligjor për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit si dhe për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Njesisë Administrative Fushë-Krujë dhe Bashkisë Krujë, për mungesë bashkëpunimi.

NJËSISË ADMINISTRATIVE FUSHË-KRUJË

FUSHË-KRUJË

BASHKISË

KRUJË

Për dijeni: Znj. D. M.
Lagja "Adem Gjeli"
Njësia Administrative Fushë-Krujë

FUSHË-KRUJË

Të nderuar

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese ligjore, në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesave të tyre të ligjshme nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, ka marrë në shqyrtim ankesë/kërkesë e shtetasës znj. D.M., banore në Njësinë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë, e cila shpreh pretendimin dhe shqetësimin për mosveprim të organeve të vetëqeverisjes vendore ndaj kërkesave të saj.

Ankuesja është banore në lagjen "Adem Gjeli", Njësia Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë. Në ankesën e saj ajo parashtroi situatën si vijon:

Pjesa e hapësirës së përbashkët që ndodhet në anën lindore të objektit në bashkëpronësi, pallatit, e cila konsiderohet si pjesa e pasme e pallatit, prej më shumë se 3 dekada e ka aksesuar nëpërmjet një dërrë të përshtatur (pasi në origjinë ka qenë dritare) të apartamentit ku banon.

Këtë hapësirë e ka përdorur për vendosje të depozitës së ujit, për tharjen e rrobave, apo të tjera veprime shtëpiake për mbarëvajtjen e jetës në përditshmëri. Në muajin tetor të vitit 2024, kjo mundësi aksesimi në hapësirën e përbashkët i është kufizuar nga vendosja e një rrjete teli nga fqinji, z. O. P., që ka në pronësi një objekt banimi, ku prej shumë vitesh dhe aktualisht nuk banon njeri. Ankuesja i është drejtuar Drejtorisë së Urbanistikës në Bashkinë Krujë si dhe Policisë Bashkiake, Bashkia Krujë, por nuk kanë vepruar pasi për ta leja e dhënë për vendosjen e rrjetës së telit nga z. O. P. ka qenë e rregullt. Por kjo për ankuesen duket e paargumentuar pasi nuk justifikohet me një dokument ku të jenë të evidentuar kufijtë e pronës së objektit të z. O. P. dhe objektit në bashkëpronësi, pallatit, ku aktualisht banon znj. D. M..

Në këto rrethana, ankuesja ka kërkuar ndërhyrjen nga ana e Avokatit të Popullit, për sqarimin dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjeve të tyre.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, institucioni i Avokatit të Popullit, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal ashtu edhe në atë substancial për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenet 13, 17 shkronja "a" dhe 18, shkronja "b", të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes¹.

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: "*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*", si dhe nenit 19 shkronja "b", të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ku parashikohet se: "*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*", në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, i jemi drejtuar me disa shkresa Njesisë Administrative Fushë-Krujë dhe Bashkisë Krujë, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje deri më sot.

Konkretisht, institucioni i Avokatit të Popullit i ka dërguar Njesisë Administrative Fushë-Krujë dhe Bashkisë Krujë, shkresat nr. K3/D21–2 prot., datë 13.08.2025 "Kërkesë për shpjegime dhe dokumentacion", nr. K3/D21– 4 prot., datë 21.09.2025 dhe nr. K3/D21– 5 prot., datë 04.11.2025 "Kërkesë e përsëritur për shpjegime dhe dokumentacion" me qëllim dërgimin e shpjegimeve në funksion të shqyrtimit të kësaj çështjeje. Në zbatim të nenit 19, paragrafi 2, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme*", kemi kërkuar që informacioni i kërkuar të na vihet në dispozicion brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga marrja e kësaj shkrese. Por, ju bëjmë me dije se përsëri nuk është kthyer përgjigje, edhe pse ka kaluar afati i përcaktuar, si dhe çdo afat i arsyeshëm kohor.

¹ Neni 13 i Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Avokati i popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur verën ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike*"

Edhe pse tashmë Avokati i Popullit ka derguar 3 (tre) shkresa në organeve të vetëqeverisjes vendore publike, ku kërkohen shpjegime mbi trajtimin e çështjes së paraqitur në ankesën e znj. D. M., përsëri sot e kësaj dite nuk ka asnjë përgjigje dhe asnjë reagim zyrtar nga ana juaj duke krijuar kështu një situatë të pazakontë, e cila ka ndikuar në afatet e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga ana e institucionit tonë.

Në rrethanat e parashtruara sa më sipër ju bëjmë me dije se, njësitë e vetëqeverisjes vendore e më konkretisht personat përgjegjës në Njësinë Administrative Fushë-Krujë dhe në Bashkinë Krujë, gjenden në shkelje flagrante të Kodit të Procedurave Administrative, duke mos zbatuar dhe cënuar rëndë parimin e respektimit të hierarkisë institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Mosdërgimi i shpjegimeve të kërkuara ka sjellë si pasojë, mostrajtimin e kësaj ankese brenda afatit ligjor dhe mungesën e korrektesës së institucionit tonë ndaj ankueses.

Ky qëndrim i mbajtur nga personat përgjegjës, punonjës në Njësinë Administrative Fushë-Krujë dhe në Bashkinë Krujë, ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit, për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme.

Ndërkohë, kjo sjellje cënon rëndë marrëdhëniet tona institucionale si dhe dëmton imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit, në publik. Mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 , të saj e ka ngritur në nivel kushtetues detyrimin e organeve të administratës shtetërore dhe funksionarëve publikë, për bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe të drejtën e këtij të fundit për të kërkuar informacion e dokumentacion Ndërkohë, kjo sjellje cënon rëndë marrëdhëniet tona institucionale si dhe dëmton imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit, në publik.

Pra, parimi i bashkëpunimit në këtë rast është kushtetues dhe detyrues për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtime. Rëndësia e këtij parimi konstatohet edhe në instrumentat ligjore që Kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut, apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës publike, apo funksionarët publikë. Neni 63 i Kushtetutës, në pikën 1, 2 dhe 3 të tij, parashikon instrumenta të tilla ligjore, në dispozicion të Avokatit të Popullit, si raportet vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet, apo propozimi për marrjen e masave administrative ndaj nëpunësve përgjegjës.

Mosveprimet e mësipërme, e vendosin institucionin tuaj përpara shkeljes së procesit të rregullt ligjor, në zhvillimin e këtij procesi administrativ, ndaj vlerësojmë se institucioni juaj duhet të përmbushë detyrimet ligjore në lidhje me procedurat, që mund të jenë shkaktuar nga: inercia, neglizhenca apo zvarritja e qëllimshme apo zvarritja e qëllimshme për përmbushjen e detyrave

funkionale, pasi Institucioni i Avokatit të Popullit ka mandat të vlerësojë jo vetëm veprimet e paligjshme të administratës publike por edhe veprimet e parregullta të saj.

Duhet theksuar se Avokati i Popullit është një institucion kushtetues, i cili ka rol “kontrollues” mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me zbatimin dhe respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t’u krijohen shanse të barabarta, e të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike, përveç gjykatave.

Gjithashtu, në ligjin nr. 8454/1999, parashikohet e drejta e institucionit tonë për të kërkuar fillimin e procedurës administrative për marrjen e masave administrative, në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike, apo nëpunësit e tyre. Në mënyrë eksplicite kjo është sanksionuar në nenin 22, të këtij ligji, në të cilin është parashikuar se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”*.

Parimi i bashkëpunimit mes organeve të administratës publike është sanksionuar si në Kodin e Procedurave Administrative, ashtu dhe në ligjin nr. 90/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”*. Në nenin 3, të këtij të fundit përcaktohet se: *“Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin”*.

Legjislatori ka parashikuar si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në trajtimin e problemeve, si dhe mungesën e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë.

Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme, të pasakta, apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti dhe administrata shtetërore ndërkohë që, të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës, janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Megjithatë, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta, theksojmë se detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e

Popullit, gjatë hetimit administrativ, veçse një detyrim i karakterit administrativ është një detyrim kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky organ publik.

Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike.

Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike, sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Në rrethanat e parashtruara sa më sipër, në rast se edhe pas këtij rekomandimi nuk mundësohet marrja e masave të nevojshme organizative për bashkëpunimin, bashkërendimin dhe bashkëveprimin e punës me Institucionin e Avokatit të Popullit, me qëllim kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave të dërguara nga Institucioni ynë, ju bëjmë me dije se nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, do të paraqiten materialet përkatëse në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Krujë, konform nenit 248, të Kodit Penal për “Shpërdorim detyre”, pasi vlerësojmë se Njësia Administrative Fushë-Krujë dhe Bashkia Krujë, është përgjegjëse për mosveprimin, apo për mungesën e dhënies së përgjigjeve përkatëse.

Referuar problematikës së hasur në këtë rast, me personat përgjegjës në respektim të afateve procedurale të kthimit të përgjigjes, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga Njësia Administrative Fushë-Krujë dhe Bashkia Krujë, titullari i këtyre organeve publik, të vlerësojnë në përputhje me ligjin organik dhe Kodin e Procedurave Administrative, veprimtarinë e personave përgjegjës mbi respektimin e afateve procedurale në shqyrtim të akteve si dhe ofrimin e shërbimeve konform legjislacionit aktual.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1, të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se:

“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e detyrimit ligjor, për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit.

2. Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës, të Njesisë Administrative Fushë-Krujë dhe të Bashkisë Krujë, lidhur me mospërmbushjen e detyrimit ligjor, për t'i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.

3. Marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi si dhe masat disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, konform nenit 22, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI
d.v